

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.G. dhe Q.G., që të dy nga P., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit A.A., avokat nga P., rruga “L.H.”, nr...., kundër të paditurve I.G., Q.G. dhe A.G., që të gjithë nga P., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit S.N., avokat nga P., në çështjen juridike kontestimore, kompensim i dëmit, vlera e kontestit 45,000.00 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, me datën 16.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve B.G. dhe Q.G., ashtu që DETYROHEN të paditurit I.G., Q.G. dhe A.G., që në emër të kompensimit të dëmit për vlerën e tokës për shkak të ndërtimit përtej vijës së kufirit të një pjese të objektit banesorë në sipërfaqe prej ... m², në ngastrën kadastrale ..., lloji i njësisë parcel, lloji i pronës private, zona urbane, lloji i shfrytëzimit tokë bujqësore dhe tokë ndërtimore, Zona Kadastrale në P., t’ia paguajnë paditësve në mënyrë solidare shumën e përgjithshme në vlerë prej 6,000.00 Euro, me kamatë si për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga datë 16.01.2019, e deri në pagesën e plotë, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiës lidhur me kompensimin e dëmit në emër të vlerës së podurimit për sipërfaqen prej ... m² në shumën prej 3,000.00 € dhe vlera e hapësirës banesore për ... kate banimi, secila në sipërfaqe prej ... m² apo sipërfaqja e përgjithshme prej ... m², në shumën prej 36,000.00 €, SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHEN të paditurit që paditësve në mënyrë solidare t’ua paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 2,886.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes padisë së ushtruar dhe të precizuar në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tyre, kanë theksuar se janë bashkëpronar të vetëm dhe legjitim të ngastrës kadastrale nr...., e cila gjendet në vendin e quajtur “N.G.”, me kulturë shtëpi – ndërtesë, me sipërfaqe prej ...m², oborr me të drejtë të shfrytëzimit të përhershëm prej ... m², dhe pjesa tjetër si arë me sipërfaqe prej ... m² ose me sipërfaqe të përgjithshme prej ... m², e cila evidentohet në Çertifikatën mbi të drejtën e pronësisë së paluajtshme nr.... ZK P., kurse të paditurit janë bashkëpronar të ngastrës kadastrale nr...., e cila ngastër kufizohet me ngastrën e paditësve. Kanë theksuar gjithashtu se të paditurit në ngastrën e tyre kanë

ndërtuar objektin e banimit kolektiv prej 7 (shtatë) etazheve, mirëpo me rastin e ndërtimit të njëjtit nuk iu kanë përmbajtur vijave përkufizuese të cilat i ndajnë ngastrat kadastrale në mes palëve ndërgjyqëse, edhe pse paditësit ua kanë tërhequr vërejtjen të paditurve se nuk janë duke u përmbajtur vijave përkufizuese të ngastrave kadastrale dhe se me një pjesë të objektit kishin kaluar në pronën e paditësve. Në prani të këtyre rrethanave paditësit kishin ushtruar propozim për rregullimin e mexhave në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku kjo e fundit me aktvendimin N.nr.1091/2004, dt.27/06/2007, ka konstatuar se të paditurit në ngastrën e tyre kadastrale kanë ndërtuar objekt të banimit kolektiv prej shtatë etazheve dhe se një pjesë e objektit është ndërtuar në pronën e paditësve dhe atë në sipërfaqe prej ... m². Andaj, paditësit i kishin ftuar të paditurit përmes shkresës së datës 18/11/2008, që të veprojnë konform aktvendimit në fjalë mirëpo të njëjtit nuk janë përgjigjur fare në shkresën në fjalë, duke mos shprehur gatishmëri për rregullimin e marrëdhënies pronësore – juridike lidhur me këtë çështje kontestimore. Nga këto veprime paditësit pretendojnë se të paditurit përpos që e kanë uzurpuar sipërfaqen prej ... m², ata paditësve u kanë shkaktuar edhe dëm në objektin e tyre, pasi që i njëjti është bërë jo funksional, për shkak të afërsisë.

Kurse gjatë seancave gjyqësore dhe fjalës përfundimtare paditësit kanë theksuar se pas administrimit të provave në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar se të paditurit kanë uzurpuar një pjesë të sipërfaqes prej ... m², dhe në të njëjtën kanë ndërtuar objektin banesor, kjo gjendje fillimisht është vërtetuar në procedurën jo kontestimore me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë N.nr.1091/2004, dt.27/06/2007, e po ashtu kjo gjendje është vërtetuar edhe në këtë procedurë kontestimore përmes ekspertizës të gjeodezisë nga ana e ekspertit gjyqësor Q.H., në bazë të së cilës konstatohet se të paditurit kanë në shfrytëzim pjesën prej ... m², të ngastrës kadastrale ... dhe mbi atë pjesë kanë ndërtuar podrumin dhe objektin banesor. Tutje kanë theksuar se nga ekspertiza financiare e ekspertit gjyqësor R.B. është konstatuar se të paditurit themelet e objektit për së gjati disa metra dhe për së gjeri disa centimetra është vendosur në pronën e paditësve dhe nga kalkulimet financiare ka ardhur në përfundim se vlera e tokës për ... m² është shumën prej 6,000.00 €, vlera e podrumit për ... m² është në shumën prej 3,000.00 €, si dhe vlerën e hapësirës banesore për ... m² për ... kate, është në shumën prej 36,000.00 €. Nga këto prova vërtetohet se me rastin e uzurpimit të ... m² nga ana e të paditurëve, paditësve iu është shkaktuar dëm, andaj, i kanë propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, ashtu që në emër të kompensimit të dëmit lidhur me uzurpimin e paluajtshmërisë për ... m², tua paguajnë për vlerën e tokës shumën prej 6,000.00 €, për vlerën e podrumit shumën prej 3,000.00 €, si dhe për ... kate të objektit banesor për secilin kat nga ... m², shumën prej 36,000.00 € apo totalin prej 45,000.00 €, me kamatë ligjore prej 3,5 % nga dita e ushtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 406.25 €, për përpilimin e një parashtrëse 406.25 €, për përfaqësimin në një seancë shumën prej 528.12 € apo 8 seanca shumën prej 4,224.96 €, për pagesën e dy ekspertizave gjyqësore dhe për dalje në teren me gjykatë shumën prej

520.00 €, si dhe taksën gjyqësore për padi në shumën prej 50.00 € apo shuma e përgjithshme e shpenzimeve prej 5,607.46 €.

Të paditurit kanë ushtruar përgjigje në padi përmes të autorizuarit të tyre, avokat S.N., përmes së cilës e kanë kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve. Kanë theksuar se në këtë çështje juridiko – kontestimore paditësve u mungon legjitimiteti real aktiv, kjo për faktin se të njëjtit nuk kanë kurrfarë raporti materialo juridik me paluajtshmërin e cila evidentohet në ngastrën kadastrale nr...., në vendin e quajtur “N.G.”, në P., për shkak se paditësit i kanë shitur të gjitha banesa dhe hapësirat tjera të cilat i kanë ndërtuar në ngastrën në fjalë. Tutje kanë theksuar se paditësit gabimisht e mbështesin bazueshmërinë e kërkesëpadiës në aktvendimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë me të cilin janë saktësuar pikat kufizuese midis ngastrave kadastrale me nr.... dhe ..., kjo pasi që ky aktvendim ka karakter vetëm konstatues e jo konstituiv dhe si i tillë nuk obligon, me arsyetimin se midis ngastrave në fjalë ka ekzistuar muri ndarës i cili ka qenë i vendosur me dekada, e të cilin fakt paditësit e kanë ditur dhe ka pasur biseda dhe pajtime lidhur me këtë fakt. Ka shtuar se në bazë të nenit 20 par.4 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore është paraparë: *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”*, e po ashtu një rregullim i tillë është paraparë edhe me nenin 40 par.1 të LPDTS, gjë që duke e pasur parasysh se të paditurit ngastrën kadastrale nr...., e kanë në shfrytëzim për më shumë se 70 viteve deri tek muri ndarës, rezulton se sipas ligjit ata e kanë fituar të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit me mirëbesim deri tek muri ndarës, i cili është i kufizuar me ngastrën kadastrale nr.... dhe Gjithashtu të paditurit kanë theksuar se sipas kushteve urbanistike të aprovuara nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, në lokacionin ku gjendet ngastra kadastrale nr...., është i lejuar ndërtimi P+2, që nënkupton se ndërtimet mbi këtë etazhitet janë ilegale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje ligjore. Po ashtu sipas kushteve urbanistike koeficienti në atë zonë është paraparë të jetë 60 me 30% në favor të oborrit dhe hapësirave për parkingje, që nënkupton se nga ... m² sa kërkohen në to është i lejuar ndërtimi vetëm në 2 m², duke theksuar se në këtë rast nuk mund të ketë dem material lidhur me funksionalitetin e ndërtesës sepse hapësira prej ... m² nuk e ka pamundësuar funksionalitetin e objektit i cili gjendet në ngastrën kadastrale ..., e po ashtu ka shtuar se këtë kërkesë për mos funksionalitet mund ta paraqesin vetëm pronarët e banesave dhe lokaleve që gjenden në atë ndërtesë, të cilët janë bashkëpronar të hapësirave të përbashkëta, e jo paditësit.

Gjatë seancave gjyqësore, si dhe gjatë fjalës përfundimtare, të paditurit kanë theksuar se nga ekspertiza e ekspertit gjeodet Q.H., është vërtetuar fakti se ngastrën kadastrale ... e shfrytëzojnë përpos paditësve edhe personi me emrin A. (H.) B., kurse ngastrën kadastrale ... e shfrytëzojnë të paditurit, ku në këto ngastra palët ndërgjyqëse i kanë ndërtuar objektet e tyre të banimit. Tutje ka theksuar nga ekspertiza e ndërtimtarisë e punuar nga V.S., rezulton se në zonën ku gjenden objektet e palëve ndërgjyqëse nuk ka

kushte urbanistike lidhur me planin zhvillimor komunal dhe me plane rregullative urbane, gjendje kjo e cila e vërteton faktin se objekti i ndërtuar nga paditësit nuk ka leje ndërtimi. Ka shtuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se të paditurit kanë filluar ndërtimin e objektit të tyre në ngastrën kadastrale në pronësi të tyre me nr...., pasi që paditësit kishin filluar ndërtimin e objektit, fakt ky që tregon se ndërtimi i objektit nga të paditurit nuk kishte paracaktuar vijën ndërtimore të objektit të paditësve, por vet paditësit paraprakisht kishin caktuar vijën ndërtimore aty ku gjendet objekti i tyre, duke theksuar se vija ndarëse në mes ngastrave kadastrale ishte kërkuar të caktohet vetëm pasi që ishte bërë ndërtimit apo ndërtimi i pjesshëm, në procedurën për caktimin e mezhdave sipas aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë N.nr.1091/2004, dt.27.06.2006. Po ashtu ka shtuar se nga skica e matjeve e cila është pjesë përbërëse e ekspertizës gjeodezike, rezulton qartë se mbi pjesën kontestuese të ngastrës kadastrale ..., mbi sipërfaqen e tokës, me ndërtesë nuk përfshihet as 1% e saj, që nënkupton se pjesa dërmuese e sipërfaqës kontestuese është përfshirë në murin nëntokësor, kurse mbi tokë ajo sipërfaqe shfrytëzohet nga banuesit e ngastrës kadastrale

Tutje kanë shtuar se gjatë ndërtimit të objekteve nuk ka të dhëna se paditësit në formë të shkruar apo në mënyrë tjetër kishin bërë vërejtje ndaj të paditurëve për kufirin e vendosjes së murit për objektin e filluar për ndërtim, që nënkupton se të paditurit kanë vepruar me mirëbesim e që konform nenit 24 të LMTHPJ, të paditurëve duhet t'iu njihet e drejta e pronësisë në pjesën kontestuese të ngastrës kadastrale nr...., mbi bazën e ndërtimit, kurse paditësve u takon vetëm e drejta për kompensim lidhur me vlerën e tokës në momentin kur bëhet kompensimi. Tutje ka theksuar se në bazë të provave të administruara rezulton se paditësit nuk mund të kërkojnë kompensimin e dëmit sipas nenit 25 par.2 LMTHPJ, sepse me asnjë provë nuk ka mundur të argumentojnë se atyre u është shkaktuar me ndërtimin e objektit nga të paditurit në kuptim të nenit 137 të LMD-së, përpos vlerës së tokës kontestuese, ku është ndërtuar muri mbajtës i ndërtesës së të paditurëve. Andaj, në prani të këtyre rrethanave i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësve sa i përket dëmeve të imagjinuara, ndërsa kërkesëpadinë sa i përket vlerës së tokës ta miratoj në pajtim me gjendjen faktike të shfrytëzimit të saj në teren dhe sipas çmimit real të tokës.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për përgjigje në padi shumë prej 120.00 €, për 5 seanca gjyqësore shumë 1620.00 €, si dhe për shpenzimet e ekspertizës së ndërtimtarisë shumë prej 120.00 €.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka zhvilluar procedurën dhe ka administruara provat dhe atë: aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë N.nr.1091/2004, dt.27.06.2006, aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC.nr.1040/2006, dt.12.08.2008, ekspertizën e datës 03.04.2006 e punuar nga ekspertet gjeodet E.V. dhe I.S., mendimin e ekspertit gjeodet Q.H. e datës 11.06.2017, ekspertizën

financiare të punuar me datën 02.04.2018 nga eksperti R.B., raportin e vlerësimit të punuar me datën 20.11.201 nga ekspertja e ndërtimtarisë dhe artitekturës V.S., si dhe certifikatën e pronës me numër 942/03-0004930/2019 e dt.09.01.2019.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Për gjykatën, ashtu edhe për palët ndërgjyqëse, nuk ishte kontestuese se të paditurit me rastin e ndërtimit të objektit banesore të tyre në ngastrën kadastrale ..., një pjesë të objektit në sipërfaqe prej ... m², e kishin ndërtuar në ngastrën kadastrale ..., pronë e paditësve. Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësit janë titullar të ngastrës kadastrale ..., lloji i njësisë parcel, lloji i pronës private, zona urbane, lloji i shfrytëzimit tokë bujqësore dhe tokë ndërtimore, ZK P..

Deri tek kjo gjendje faktike, kjo gjykatë ka ardhur duke u bazuar në provat, si vijon: aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë N.nr.1091/2004, dt.27.06.2006, aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC.nr.1040/2006, dt.12.08.2008, ekspertiza e datës 03.04.2006 e punuar nga ekspertet gjeodet E.V. dhe I.S., mendimi i ekspertit gjeodet Q.H. e datës 11.06.2017, si dhe certifikata e pronës me numër ... e dt.09.01.2019, nga të cilat prova vërtetohet se të paditurit kanë ndërtuar një pjesë të objektit të tyre në ngastrën kadastrale të paditësve, në sipërfaqe prej ... m².

Në këtë çështje juridiko civile, kontestuese ishte fakti se të paditësve a u takon e drejta për kompensim të dëmit vetëm për vlerën e tokës apo i takon kompensimi i dëmit edhe për vlerën e podrumit dhe vlerën e ... kateve të banimit.

Gjykata pasi që ka vlerësuar dhe analizuar me kujdesë të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve duhet të miratohet pjesërisht si e bazuar lidhur me kompensimin e dëmit lidhur me vlerën e tokës, kurse lidhur me vlerën e podrumit për ... m², dhe vlerën e ... kateve të banimit secili katë nga ... m², apo sipërfaqja totale prej ... m², duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Deri tek ky konstatim kjo gjykatë ka ardhur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 25 par.5 të Ligjit për marrëdhëniet themelore juridiko pronësore, në të cilën është paraparë: *“Në qoftë se ndërtuesi është me mirëbesim, kurse pronari i tokës nuk ka ditur për ndërtimin, në rastin kur objekti ndërtimor vlen shumë më tepër se toka, objekti ndërtimor bashkë me tokën i takojnë ndërtuesit, kurse ky pronarit të tokës i ka borxh kompensimin sipas çmimit të qarkullimit të tokës”*. Nga shkresat e lëndës dhe deklaratimet e palëve të dhëna gjatë shqyrtimeve gjyqësore pranë kësaj gjykate, rezulton se kur të paditurit kanë

filluar ndërtimin e objektit banesorë, nuk e kanë ditur se një pjesë e objektit të tyre ka filluar të ndërtohet në ngastrën kadastrale e cila evidentohet në emër të paditësve dhe atë në sipërfaqe prej 6 m², çka nga kjo gjendje rezulton se të paditurit kanë qenë me mirëmbesim me rastin e ndërtimit të objektit banesor. Nga dispozita ligjore e lartcekur, është përcaktuar se në rast se vlera e tokës është më e vogël se vlera e objektit i cili është ndërtuar, pronarit të tokës i takon e drejta që të kërkoj kompensimin e dëmit nga ndërtuesi vetëm për vlerën e tokës në kohën kur merret vendimi gjyqësor, kurse në anën tjetër kjo dispozitë ligjore e ka përjashtuar të drejtën e pronarit të tokës që të kërkoj kompensimin e dëmit për vlerën e pjesës së objektit i cili është ndërtuar në pronën e tyre, përkatësisht në rastin konkret, ... m² në emër të vlerës së podrumit dhe ... m², në emër të vlerës së hapësirës banesore, për ... kate banimi nga ... m².

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka nxjerr ekspertizën financiare të punuar nga eksperti R.B. e datës 02.04.2018, si dhe raportin e vlerësimit nga ekspertja V.S. e datës 20.11.2018.

Nga mendimi dhe konstatimi i dhënë nga eksperti R.B., përmes ekspertizës së datës 02.04.2018, të cilën ekspertizë e ka mbrojtur edhe gjatë seancës gjyqësore të datës 12.06.2018, rezulton se eksperti në fjalë ka bërë përlllogaritjen e vlerës së tokës në tre forma dhe atë në emër të vlerës së tokës në sipërfaqe prej ... m², ka vlerësuar shumën prej 6,000.00 €, apo për ... m², shumën prej 1,000.00 €, për vlerën e podrumit në sipërfaqe prej ... m², ka vlerësuar shumën prej 3,000.00 € apo për ... m² shumën prej 500.00 €, si dhe në emër të vlerës së hapësirës banesore për 6 kate nga 6 m², apo sipërfaqen prej 36 m², ka vlerësuar në shumën prej 36,000.00 €, apo për ... m² shumën prej 1,000.00 €.

Edhe ekspertja e ndërtimtarisë V.S. përmes raportit të vlerësimit të datës 20.11.2018, ka dhënë konstatimin se pajtohet në tërësi me vlerësimin e bërë nga eksperti R.B., duke konstatuar se vlerën e ngastrës kadastrale ..., për ... m², në tre forma dhe atë si vlerë e tokës për ... m² shuma prej 6,000.00 € (... m² x 1,000.00 €), si vlerë e podrumit për ... m² shuma prej 3,000.00 € (... m² x 500.00 €) dhe si vlerës e hapësirës banesore për ... kate banimit nga ... m², sipërfaqja totale prej ... m², në shumën prej 36,000.00 €, (... m² x 1,000.00 €).

Ekspertizave financiare dhe të ndërtimtarisë gjykata ia fali besimin e plotë vetëm sa i përket përket vlerës së tokës për këtë formë të kompensimit, ngase ekspertizat përmbajnë elementet e nevojshme të dhënë mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore, respektivisht ekspertizat, si ajo financiare ashtu edhe ajo e ndërtimtarisë, nuk është kundërshtuar me prova konkretet nga palët ndërgjyqëse dhe nuk kishte ndonjë propozim për plotësimin e ekspertizave apo nxirrjen e ekspertizave tjera, andaj gjykata ka caktuar kompensimin e dëmit për paditësit në shumën prej 6,000.00 €,

në emër të ndërtimit përtej vijës së kufirit, ashtu siq është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e konsideruar se vlerësimi i bërë është real dhe në përputhje me dëmin i cili u është shkaktuar paditësve.

Kurse pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve lidhur me kompensimin e vlerës së podrumit për ... m², në shumën prej 3,000.00 € dhe për vlerën e hapësirës banesore për ... kate banimit në sipërfaqe prej ... m² apo sipërfaqja totale prej ... m², në shumën prej 36,000.00 €, gjykata e refuzoj si të pabazuar, pasi që pronarit të tokës i takon vetëm e drejta e kompensimit të vlerës së tokës në rast se kjo vlerë është më e vogël e vlera e objektit të ndërtuar, kurse nuk i takon e drejta e vlerës në objektin e ndërtuar, andaj, duke e patur parasysh se vlera e objektit të ndërtuar është më e madhe se vlera e tokës, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konform dispozitës së nenit 25 par.5 të LMTHPJ.

Sipas dispozitës të nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa në dispozitën e nenit 319.1 të LPK-së parashihet që secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë t'i provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Në rastin konkret gjykata nuk ka mundur të pranoj pretendimet e paditësve sa i përket kompensimit të vlerës së podrumit për ... m², në shumën prej 3,000.00 € dhe për vlerën e hapësirës banesore për ... kate banimit në sipërfaqe prej ... m² apo sipërfaqja totale prej ... m², në shumën prej 36,000.00 €, pasi që paditësit nuk kanë prezantuar prova me të cilat e vërtetojnë bazueshmërin e kërkesëpadisë, sipas detyrimit që kanë palët konform dispozitave nga nenit 7 të LPK-së.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 277 të LMD-së dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurve për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e marrjes së aktgjykimit.

Vendimin që të paditurit ti bartin shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nga neni 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Lartësia e shpenzimeve të procedurës gjyqësore të aprovuara i referohet shpenzimeve për padi shumën prej 156.00 €, taksë gjyqësore për padi shumën prej 500.00 €, për 7 seanca të mbajtura për secilën seancë shumën prej 270.00 €, për taksën për daljen në vend shumën prej 20.00 €, për ekspertizën e gjeodezisë shumën prej 200.00 €, si dhe për ekspertizën financiare shumën prej 120.00 €, apo në total shumën prej 2,886.00 €.

Andaj duke marrë parasysh të gjitha ato që u theksuan më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2666/08, dt.16.01.2019

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja
e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën
e Apelit në Prishtinë.

Gjyqtari,
Ylber Shurdhiqi